



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:249/26, Datë: 27.02.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Rregulloren (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 146 të mbajtur më 23.02.2026, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** në nivel institucional Akademia e Kosovës për Siguri Publike, për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2026 deri me 30 shtator 2031).
- II. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike që deri me 30 shtator, të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim planin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.949/25, datë 31.07.2025, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditim në nivel institucional.

AKA me datë 27.12.2025 ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademia e Kosovës për Siguri Publike me qëllim të vlerësimit në nivel institucional.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit institucional, Akademia e Kosovës për Siguri Publike është vlerësuar se i përmbushë:

- Plotësisht dhjetë (10) standarde;
- Substancialisht një (1) standard të akreditimit.

Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka rekomanduar që Akademia e Kosovës për Siguri Publike të akreditohet për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 1 tetor 2026 deri me 30 shtator 2031.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 146-të, të mbajtur me 23.02.2026 ka shqyrtuar kërkesën e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi ju dërgohet :

- Akademisë së Kosovës për Siguri Publike ;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.